



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

PËR

**TRANSFERIMIN E PORTOFOLIT TË SIGURIMIT NË LIDHJE ME VENDET
ANËTARE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 56, datë 26.05.2017

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për transferimin e portofolit të sigurimit në lidhje me vendet anëtare.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet në rastin e transferimit të portofolit të shoqërisë së sigurimit tek:

- a. Dega e vetë shoqërisë në një vend anëtar;
- b. Një shoqëri sigurimi të një vendi anëtar, e cila ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose dega e saj, e licencuar në Republikën e Shqipërisë;
- c. Një shoqëri sigurimi të një vendi anëtar ose dega e saj në një vend anëtar;
- d. Dega e një shoqërie sigurimi të një vendi të huaj të lejuar për të vepruar në një vend anëtar kur kontratat e sigurimit që do të transferohen mbulojnë rreziqe që ndodhen në atë vend anëtar.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 47, pika 5, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 4

Përkufizime

- a. **“Autoriteti”** – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- b. **“Vendet anëtare”** – vendet anëtare të Bashkimit Evropian ose vende të tjerë që i përkasin Zonës Ekonomike Evropiane.
- c. **“Portofol sigurimi”** – tërësia apo një pjesë e kontratave që do të transferohen nga një shoqëri sigurimi tek tjetra.
- d. **“Shoqëri transferuese”** – shoqëria e sigurimit, e cila transferon portofolin e sigurimeve tek një shoqëri tjetër sigurimi.
- e. **“Shoqëri pranuese”** – shoqëria e sigurimit, tek e cila transferohet portofoli i sigurimeve nga një shoqëri tjetër sigurimi.

Neni 5

Miratimi nga Autoriteti

Transferimi i portofolit nga shoqëria transferuese tek shoqëria pranuese ose dega e saj në vendin anëtar, sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, kryhet pasi merret miratimi nga Autoriteti.

Neni 6

Dokumentacioni për miratimin e transferimit

- 1. Kërkesa për marrjen e miratimit të transferimit të portofolit të sigurimeve të shoqërisë transferuese tek shoqëria pranuese ose dega e saj në vendin anëtar duhet të shoqërohet nga:
 - a. Kontrata e transferimit të portofolit të sigurimeve ndërmjet shoqërisë transferuese dhe shoqërisë pranuese;
 - b. Plani i biznesit për marrjen e portofolit të sigurimit nga shoqëria pranuese;

- c. Deklarata që shoqëria pranuese zotëron, duke marrë parasysh dhe transferimin e portofolit, nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;
- d. Dokumenti që vërteton pagesën e tarifave administrative dhe shpenzimeve në lidhje me transferimin e portofolit;
- e. Përveç dokumentacionit të përcaktuar më sipër, Autoriteti, kur e sheh të nevojshme mund t'i kërkojë shoqërisë aplikuese të paraqesë dokumente shtesë për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën e paraqitur.

Neni 7

Transferimi i portofolit të sigurimit tek dega e vetë shoqërisë në një vend anëtar

1. Shoqëria transferuese transferon portofolin e sigurimit tek dega e saj në një vend anëtar, kur kontratat e sigurimit që do të transferohen mbulojnë rreziqe që ndodhen në atë vend.
2. Në këtë rast, Autoriteti njofton autoritetin kompetent të vendit anëtar për transferimin e portofolit.

Neni 8

Transferimi i portofolit tek një shoqëri sigurimi të një vendi anëtar, e cila ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose dega e saj, e licencuar në Republikën e Shqipërisë

1. Shoqëria e sigurimit transferon portofolin e sigurimit tek shoqëria e sigurimit të një vendi anëtar, e cila ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo tek dega e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar, e licencuar në Republikën e Shqipërisë.
2. Në këtë rast, Autoriteti, para dhënies së miratimit për transferimin e portofolit të sigurimit, kërkon miratimin për transferimin e portofolit nga autoriteti kompetent i vendit anëtar.
3. Autoriteti mund të refuzojë transferimin e portofolit të sigurimit nëse gjykon se ky transferim çënon interesat e të siguruarve.
4. Shoqëria pranuese, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Autoritetit për miratimin e transferimit të portofolit, njofton të siguruarit për këtë transferim me anë të mjeteve publike të komunikimit në territorin ku ndodhet rreziku i mbuluar nga kontratat e sigurimit të transferuara.

Neni 9

Transferimi i portofolit të sigurimit tek një shoqëri sigurimi të një vendi anëtar ose dega e saj në një vend anëtar

1. Në rastin kur shoqëria e sigurimit transferuese transferon portofolin e sigurimit tek shoqëria e sigurimit të një vendi anëtar, Autoriteti, para dhënies së miratimit për transferimin e portofolit, kërkon miratimin nga autoriteti kompetent i vendit anëtar.
2. Autoriteti kompetent i vendit anëtar jep miratimin për shoqërinë pranuese të sigurimit, nëse kjo shoqëri do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit edhe pas marrjes së portofolit të sigurimit të transferuar.
3. Nëse portofoli i sigurimit mbulon gjithashtu rreziqe në një tjetër vend anëtar, Autoriteti mund të japë miratimin për transferimin e portofolit të sigurimit vetëm nëse autoriteti kompetent i vendit anëtar jep aprovimin e tij.
4. Nëse brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës, autoriteti kompetent i vendit anëtar nuk përgjigjet, transferimi i portofolit të sigurimit do të konsiderohet i miratuar në heshtje.

Neni 10

Transferimi i portofolit të sigurimit tek dega e një shoqërie sigurimi të një vendi të huaj të lejuar për të vepruar në një vend anëtar kur kontratat e sigurimit që do të transferohen mbulojnë rreziqe që ndodhen në atë vend anëtar

1. Shoqëria transferuese transferon portofolin e sigurimit tek dega e një shoqërie sigurimi të një vendi të huaj të lejuar për të vepruar në një vend anëtar kur kontratat e sigurimit që do të transferohen mbulojnë rreziqe që ndodhen në atë vend anëtar.
2. Në këtë rast, Autoriteti kërkon miratimin nga autoriteti kompetent i vendit anëtar për transferimin e portofolit.
3. Autoriteti kompetent i vendit anëtar në miratimin e transferimit të portofolit vërteton gjithashtu se shoqëria pranuese edhe pas transferimit të portofolit, do të vijojë të zotërojë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.
4. Nëse brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës, autoriteti kompetent i vendit anëtar nuk përgjigjet, transferimi i portofolit të sigurimit do të konsiderohet i miratuar në heshtje.

Neni 11
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.